

EC

MA NDRYSHE

EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RICIKLO -

EKO KLUBI

"XHELAL HAJDA-TONI"



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



Të dashur lexues,

Kjo është seria e dytë buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Shkollës së Mesme të Lartë “Xhelal Hajda - Toni” dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “ECO School”.

Ky projekt do t’i njohë me konceptin “Eko Shkolla” 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësuesve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).

ROLI I BIODIVERSITETIT NË ZHUKJEN E VARFËRISË DHE URISË



Njerëzit me mjete jetese të bazuara mbi ekzistencën shpesh varen thellësisht dhe drejtpërdrejt nga biodiversiteti për sigurimin e mjeteve të tyre të jetesës. Për shembull, në zonat rurale në Zimbabve, produktet e egra sigurojnë 37 % të të ardhurave totale familjare, dhe në tokat e thata të Indisë, ku produktet e egra sigurojnë normalisht 14-23% të të ardhurave më të pamjaftueshme në zonat rurale, në kohët e thatësirës kjo rritet deri në 42-57% ¹.

Mënyrat nëpërmjet të cilave një familje e varfër siguron të ardhurat dhe plotëson nevojat e saj bazë plotësohen shpesh nëpërmjet aktiviteteve të jetesës që lidhen me mjedisin natyror. Për shembull, shfrytëzimi i burimeve të zakonshme të pronës (aseteve) të tilla si peshqit, kullotat ose pyjet mund të sigurojnë të ardhura, ushqim, barna, lëndë djegëse, thesë (tagji-ushqim të thatë) për bagëtitë dhe materiale ndërtimi.

Të varfërit, si rrjedhim ndikohen ndjeshëm kur mjedisi degradohet, kur ka humbur biodiversiteti ose mundësia e njerëzve për të ndikuar mbi to është kufizuar ². Burimet e Biodiversitetit gjithashtu po hyjnë gjithnjë e më shumë në vëmendje përmes programeve të mikro-kredive (kredive të vogla), shumica e të cilave bazohen në mënyra të ndryshme të jetesës që mbështeten në përdorimin mbështetës të kallamishteve, barërave dhe produkteve pyjore jo-për lëndë druri.

ROLI I BIODIVERSITETIT NË ZHUKJEN E VARFËRISË DHE URISË



Biodiversiteti është gjithashtu kritik për mbrojtjen dhe rivlerësimin e sigurisë së ushqimeve. Konservimi dhe ruajtja e tokës së shëndetshme, ujit të pastër, një shumëllojshmërie të burimeve gjenetike dhe proceseve ekologjike janë përbërësit thelbësorë të një sistemi bujqësor mbështetës dhe prodhues dhe zhdukjes së mëvonshme të urisë.

Shumëllojshmëria në biodiversitetin gjenetik është veçanërisht e rëndësishme në tokat e varfra, ku përshtatjet gjenetike ndaj kushteve të tilla si mungesa e ujit dhe pjelloria e ulët e tokës janë kritike për ruajtjen e bujqësisë lokale të jetesës së kullotave. Përtej burimeve bujqësore tokësore, përbërës të tjerë të biodiversitetit që duhet të mbrohen për të garantuar sigurimin e ushqimit përfshijnë peshkimin, që varet nga mbrojtja e ekosistemeve, të tilla si lagunat, rizoforet dhe gumët e koralit, që iu sigurojnë peshqve mjedisin banues dhe jetesën.


[HTTPS://WWW.CBD.INT/DOC/BIODAY/2007/IBD-2007-ALBANIA-FACTSHEETS-AL.PDF](https://www.cbd.int/doc/bioday/2007/ibd-2007-albania-factsheets-al.pdf)






AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE
EÇ MA NDRYSHE





DOKUMENTAR MJEDISOR ME EKO -KLUBET

Dokumentari mjedisor në "Kino Lumbardh" për 12 Eko - Klubet e Shkollave të Mesme të Rajonit të Jugut (Prizren, Rahovec, Malishevë dhe Mamushë). Ky aktivitet është pasuar me diskutim në mes anëtarëve të eko klubeve mbi çështjet mjedisore të trajtuara në dokumentar.

Gjatë këtij aktiviteti u shqyrtua se si veprimet tona të pakujdesshme ndaj natyrës çojnë drejt degradimit të planetit, ta bëjnë atë të pabanueshëm për miliona njerëz dhe si do të sjellin shkatërrimin e popullatave të biodiversitetit.

Ky aktivitet përveç njohurive të reja dhe aktivizimit të nxënësve për të ofruar zgjidhje të ndryshme mbi këto çështje, po ashtu kontribuoi edhe për shoqërimin e tyre duke ndarë mes vete përvojat për aktivitetet mjedisore që ata realizojnë në shkollat e tyre.



EKO KLUBI "XHELAL HAJDA - TONI"

RAHOVEC, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".